**Nr. 1676 Prot,**

**Divjakë, më: 27/02/2026**

**MIRATOI:**

**KRYETARI**

**JOSIF GORREA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË

BASHKIA DIVJAKË

# *BASHKIA DIVJAKË*

# *RAPORT MBI MONITORIMI E ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIVJAKË**
**DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT**

# RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR–DHJETOR 2025

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar,të ligjit nr.68/2017 dt.27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni nr.48 " Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit vendor" ,ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin esistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit plotësues nr.2 dt.24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Udhëzimit nr.22 dt.30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes vendore", Ligjit nr.115/2024 dt.03.12.2024 "Për Buxhetin e vitit 2025, ju informojmë mbi realizimin e Buxhetit për periudhën Janar – Gusht 2025 për Bashkinë Divjakë. Buxheti i vitit 2025 dhe Programi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 Faza Përfundimtare është miratuar me vendim te Këshillit Bashkiak nr.65 dt.24.12.2024 të miratuara nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr.1359/1 dt.31.12.2024 protokolluar në Bashkinë Divjakë nr.18 prot dt.06.01.2025.Objektiv themelor i Bashkisë Divjakë do të jetë garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm të Divjakës, për të përmirësuar jetesën e brezave të sotëm dhe për të garantuar mirëqënien e brezave të ardhshëm.
Objektivat e vitit 2025

- Përmirësimi i hapësirave publike, sipërfaqeve të gjelbërta, ndriçim etj.
- Përmirësimi i infrastrukturës së munguar për asetet e qytetit dhe njësive administrative.
- Investime dhe rehabilitimi/zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe rritja e mbulimit me shërbim.
- Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së procesit mësimor.
- Rritja e sigurisë në rrugë dhe në objektet shkollore.
- Rritja e aksesueshmërisë për grupet e pafavorizuara.
- Nxitja e zhvillimit ekonomik, punësimit e sipërmarrjes.
- Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit.
- Nxitja e zhvillimit rural dhe turizmit dhe ndihmesë bujqësisë.
- Rivitalizimi i jetës kulturore, artistike, sportive, gjithë sektorëve kreativë dhe turizmit.
- Përmirësimi i shërbimeve të varrezave publike.
- Ofrimi i shërbimeve socaile cilësore.
- Promovimi i vlerave evropiane përmes aktiviteteve artistike.
- Sistemimet e rrugëve të brendëshme të fshatrave
- Ndërtimi i rrugëve rurale dhe bujqësore në shërbim të komunitetit.
- Rikonstruksioni i kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në Njesitë Administrative të Bashkisë Divjakë, duke përmiresuar kushtet për arsimimin e brezit të ri.
- Rikonstruksioni i Qendrave Shëndetësore për një shërbim cilësor ndaj komunitetit.
- Përmirësimi i menaxhimit financiar të bashkisë përmes rritjes së efiçensës së përdorimit të fondeve publike dhe uljes së detyrimeve të prapambetura.
- Rritja e cilësisë së shërbimit për pastrimin dhe mbetjet urbane.

- Rritja e disiplinës fiskale për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore.
- Përmiresimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit në të gjithë territorin e Bashkisë, thithja e projekteve të Bankës Botërore për pastrimin e kanaleve e kullues dhe vaditës.
- Trajnimi i administratës dhe futja e teknologjisë bashkëkohore.

## ❖ I-VËSHTRIM MBI TË ARDHURAT E BASHKISË

Pasqyra e të ardhurave të realizuara për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2025
Vlerat shprehur në .000 lekë

| Nr | Emërtimi | Parashikimi Viti 2025 | Realizimi Viti 2025 | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|
| **I** | **Të ardhurat nga taksat vendore** | **115,237** | **107,091** | **93** |
| 1 | Tatimi mbi të ardhurat personale 2% | 11,930 | 18,467 | 155 |
| 2 | Taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 75,258 | 58,510 | 78 |
| | a)Taksa mbi ndërtesat | 23,000 | 14,543 | 63 |
| | b)Taksa mbi tokën bujqësore | 51,918 | 43,495 | 84 |
| | c) taksa e truallit | 340 | 472 | 139 |
| 3 | Taksa e fjetjes në hotel | 397 | 288 | 73 |
| 4 | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 9,000 | 9,047 | 101 |
| 5 | Taksa mbi kalimin e të drejtës pronësisë mbi pasuritë | 440 | 78 | 18 |
| 6 | Taksa vjetore mbi automjetet e përdorura | 18,000 | 20,494 | 114 |
| 7 | Taksa e tabelës dhe reklamës | 212 | 207 | 98 |
| | | | | |
| **II** | **Të ardhurat nga Tarifat Vendore** | **97,331** | **97,767** | **100** |
| 1 | Tarifa e Menaxhimit të mbetjeve urbane | 30,100 | 29,032 | 96 |
| 2 | Tarifa e Ndriçimit publik | 8,062 | 7,731 | 96 |
| 3 | Tarifa e Gjelbërimit publik | 3,273 | 3,167 | 97 |
| 4 | Tarifë Parkimi | 200 | 160 | 80 |
| 5 | Tarifë për zënien e hapësirave publike | 7,100 | 7,152 | 101 |
| 6 | Tarifa e tregut të lirë tregje publike | 2,300 | 1,745 | 76 |
| 7 | Të ardhura tarifa shëtitjes me varkë | 7,500 | 8,203 | 109 |
| 8 | Të ardhura tarifa kullës vizitorëve | 4,500 | 3,430 | 76 |
| 9 | Të ardhura nga tarifa për kopështet | 2,300 | 2,709 | 118 |
| 10 | Tarifa për kulturën dhe sportin | 135 | 40 | 30 |
| 11 | Tarifa e punimeve me deklaratë paraprake | 400 | 130 | 33 |
| 12 | Të ardhura nga tarifa e ujitjes në bujqësi | 5,000 | 1,944 | 39 |
| 13 | Tarifa e mirëmbajtjes së rrjetit ujitës e kullues | 7,000 | 6,878 | 98 |
| 14 | Tarifa e deinsektimit | 1,974 | 965 | 49 |
| 15 | Të ardhura nga tarifa të tjera | 17,487 | 24,481 | 140 |
| | | | | |
| **III** | **Të Ardhura të tjera** | **6,052** | **3,327** | 55 |
| 1 | Qera Trualli & ndërtese | 4,004 | 3,315 | 83 |
| 2 | Qera toke bujqësore | 2,048 | 12 | 1 |
| **IV** | Shitje Asetesh | - | - | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| V | Grant i trashëguar viti 2024 | - | - | |
| VI | Të Ardhura të Trashëguara viti 2024 | - | - | |
| | TOTALI | 218,620 | 208,185 | 95 |

Për periudhën Janar – Dhjetor 2025 kemi realizuar gjithsej 208,185,000 lekë të ardhura nga 218,620,000 lekë të parashikuara ose 95% në përqindje. Për të patur më të qartë situatën e taksapaguesve nga pikëpamja sasiore po ju bashkëlidhim më poshtë tabelën për kontribuesit të ndarë në segmentin Biznes dhe Familjar për vitin 2025.

| Nr. | Emërtimi Njesisë | Biznese numër | | Familjar numër | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Planifikuar | Realizuar | Planifikuar | Realizuar |
| 1 | Njësia Divjakë | 317 | 267 | 3,680 | 1,399 |
| 2 | Njësia Administrative Tërbuf | 138 | 104 | 3,648 | 1,011 |
| 3 | Njësia Administrative Grabian | 36 | 35 | 1720 | 373 |
| 4 | Njësia Administrative Gradishtë | 92 | 89 | 2,727 | 901 |
| 5 | Njësia Administrative Remas | 38 | 36 | 1,768 | 978 |
| 6 | Totali | 621 | 531 | 13,543 | 4,662 |

Të ardhurat nga Taksat vendore janë realizuar në masën 107, 091,000 lekë nga 115,237,000 lekë të planifikuara ose në masën 93%. Në territorin e Bashkisë Divjakë në fillim të vitit 2025 ushtrojnë aktivitete private 621 subjekte të tipit biznes nga të cilat gjatë vitit janë kryer 531 pagesa për detyrimet për Taksat dhe Tarifat vendore ose 85.5% në numër .

Sipas të dhënave që dispozojmë kemi 11,174 familjare që kanë përfituar AMTP dhe në rregjistrat e taksave kemi në fillim të vitit 2025 një numër prej 13,543 taksapagues për taksat e pasurisë së paluajtshme. Kemi përgatitur akt detyrimet dhe njoftimet për detyrimet sipas ligjit, nga të cilët kanë paguar detyrimet për taksa dhe tarifat vendore 4,662 prej tyre deri në fund të muajit dhjetor 2025. Për pjesën e realizuar të njoftim detyrimeve të përgatitura në këtë periudhë kemi operuar për shpërndarjen e tyre nëpermjet rrugës postare. Të ardhurat nga Taksat mbi pasurinë e paluajtshme janë realizuar në masën 58,510,000 lekë. Kemi një realizim prej 78%, për këtë grup të ardhurash peshën më të madhe e zë realizimi në taksën e ndertesës dhe të tokës bujqësore me vlera respektivisht një realizim prej 14,543,000 lekë për taksën e ndërtesës dhe 43,495,000 lekë për pasurinë e llojit tokë bujqësore. Po ashtu edhe taksa mbi truallin e ka kaluar planin tonë me një realizim të të ardhurave me 139%, duke realizuar 472,000 lekë nga 340,000 lekë të planifikuara.

Kështu, arsye specifike në këtë realizim mjaft të kënaqshëm të segmentit familiar si për Taksën mbi tokën bujqësore që është zëri kryesor, por edhe për taksën mbi ndërtesat, është fakti se ka përfunduar shpërndarja e plotë e njoftim detyrimeve. Faktor kyç në realizimin kaq të kënaqshëm të këtyre të ardhurave është dhe efekti i masave shtrënguese i bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesve debitorë. Po ashtu edhe taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paraqitet të jenë grumbulluar të ardhura në një nivel të kënaqshëm në lidhje me nivelin e planifikuar. Kemi planifikuar 9,000,000 lekë nga të cilat janë realizuar 9,047,000 lekë ose në masën 101 %. Realizimi në vlerë absolute është 47,000 lekë më shumë seç kishim planifikuar. Arsye kryesore në realizimin mjaft të kënaqshëm të të ardhurave në këtë zë është masat shtrënguese për pagesë të detyruar siç janë urdhër bllokimet në llogari bankare por edhe pagesat vullnetare të vetë qytetarëve, kjo pasi janë njoftuar në mënyrë shkresore nëpërmjet njoftim

detyrimeve dërguar nga posta, duke qënë se këtë pagesë e shohin si një hap më të shpejtë për marrjen e dokumentit të pronësisë së objektit të tyre. Edhe pagesat nga segmenti i biznesit paraqiten në nivele të kënaqshme. Kemi plotësuar dhe shpërndarë në kohë njoftim detyrimet për segmentin biznes duke e adresuar atë drejt bizneseve nëpërmjet rrugës postare. Një efekt pozitiv në ketë drejtim për arkëtimin e të ardhurave ka qenë vazhdimi i mosofrimit të shërbimeve në zyrat e bashkisë nqs qytetari nuk ka kryer pagesën e taksave dhe tarifave vendore. Nga Taksa mbi tokën Bujqësore kemi mbledhur për vitin 2025 vlerën 43,495,000 lekë nga 51,918,000 lekë të planifikuara ose 84%. Nga taksa mbi ndërtesat kemi vjelë 14,543,000 lekë nga 23,000,000 të planifikuara ose 63%. Siç shihet qartë i jemi afruar kënaqshëm planit 100 % të realizueshëm.

Gjatë periudhës janë marë masa nga Drejtoria jonë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit për sensibilizimin dhe kryerjen e pagesave nga qytetarët të cilët janë në proces legalizimi nga ASHK Lushnje. Njëkohësisht i kemi dërguar të gjithë familjarëve të mbërritur me listat e reja dhe të përfshirë në listat e legalizimeve sipas ASHK njoftimin dhe kërkesën për të paguar si dhe rinjoftuar taksapagues nga vitet 2022-2024 të cilët nuk janë përgjigjur me njoftimin e parë, si dhe njoftime detyrimi për vitin 2025.

Të ardhurat nga Tarifat Vendore janë realizuar në masën 97,767,000 lekë nga 97,331,000 të planifikuara ose 100% të realizuara. Të ardhurat nga Tarifa e menaxhimit të mbetjeve janë realizuar në masën 29,032,000 lekë nga 30,100,000 lekë të planifikuara ose 96 %. Të ardhura nga tarifa e ndriçimit publik paraqiten në masën 96 % ose 7,731,000 lekë nga 8,062,000 te planifikuara. Të ardhurat nga tarifa e gjelbërimit publik janë rezalizuar në masën 97 % ose në vlerë absolute vetëm 106,000 lekë më pak seç kemi planifikuar.

Për vitin 2025 kemi patur një realizim mjaft të kënaqshëm në të gjitha zërat që paraqesim tek Pasqyrave e të Ardhurave kjo gjë ka ndodhur pasi njoftim detyrimet janë shpërndarë në kohë, bizneset kanë paguar detyrimet e viteve të mëparshme, taksapaguesit familjarë po ndërgjegjësohen dhe po fillojnë të paguajnë detyrimet që ata kanë patur ndër vite si dhe masat shtrënguese për vjeljen me forcë të detyrimeve sic janë urdhër bllokimet në llogarinë bankare kanë qënë shumë efektive kjo për arsye edhe që shumë fermer kanë kryer aplikimiet për rimbursimin e naftës në bujqësi dhe kanë hapur masivisht llogari bankare.

Një realizim të kënaqshëm e kemi nga të ardhurat nga kulla e vizitorëve dhe nga shëtitja me varkë pasi ka pasur një numër të konsiderueshëm të turistëve që kanë vizituar këto pika turistike, ku nga 7,500,000 lekë të planifikuara nga shtëtitjet me varkë kemi një realizim prej 8,203,000 lekë ose 109% në përqindje. Të ardhurat nga biletat në kullën e vizitorëve janë realizuar në masën 76% ku kemi planifikuar të mbledhim 4,500,000 lekë dhe kemi mbledhur 3,430,000 lekë.

Të ardhura nga tarifa e parkimit nga 200,000 lekë të planifikuara janë realizuar vetëm 160,000 lekë ose në masën 80%. Këto të ardhura janë mbledhur vetëm nga tarifat e parkimit për autovetura taksi, kjo për arsye se me vendim të Këshillit Bashkiak nr.36, datë 24.07.2023 Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Divjakë, nr 53 datë 25.11.2022 "Paketa Fiskale për Sistemin e Taksave e Tarifave Vendore dhe Penalitetet për kundravajtjet Administrative për vitin 2023" , është hequr tarifa e parkimit në zonën e bregdetit për të gjithë pushuesit që hyjnë me makina në zonën e plazhit.

Kemi patur një realizim tepër të kënaqshëm edhe nga tarifa e tregut të lirë nga ku janë mbledhur 1,745,000 lekë nga 2,300,000 lekë të planifikuara ose 76%. Kjo ka ndodhur për arsye se është bërë rimatje për sipërfaqet që në vitin 2024 dhe tregëtarët kanë paguar për atë sipërfaqe që kanë zënë realisht.

Nga ana tjetër kemi një realizim të kënaqshëm prej 2,709,000 lekë nga tarifa e kopështeve me drekë të Divjakës dhe Çermë Sektorit, nga 2,300,000 lekë të planifikuar duke arritur kështu masën 118% dhe duke e kaluar planin me 18%.

Po ashtu nga tarifa e deinsketimit kemi një realizim në një raport 49 % në realizim ose në vlerë absolute 1,009,000 lekë më pak nga ku kemi realizuar 965,000 lekë nga 1,974,000 lekë të planifikuara. Të ardhurat e vjelura nga kjo tarifë janë mbledhur vetëm nga vlerat debitore, pasi me vendim të Këshillit Bashkiak nr.58, datë 25.11.2024 "Paketa Fiskale për Sistemin e Taksave e Tarifave Vendore dhe Penalitetet për kundravajtjet Administrative për vitin 2025" , është zeruar si tarifë qoftë për taksapaguesit familjarë dhe ata të tipit biznes.

Për tarifa për zënien e hapësirave publike ka patur një realizim prej 7,152,000 lekë, dhe për këtë tarifë kemi planifikuar për vitin 2025 vlerën prej 7,100,00, duke arritur kështu vlerën prej 101% të realizuara.

Gjithashtu edhe nga tarifa e mirëmbajtjes së kanaleve kulluese dytësore në zonat fushore kemi një realizim mjaft të kënaqshëm ku nga 7,000,000 lekë të planifkuara kemi realizuar 6,878,000 lekë të ardhura ose në masën 98%. Më poshtë jepet një tabelë më e detajuar nga pikëpamja sasiore e të ardhurave të realizuara në numër pagesash dhe në vlerë leku për vitin 2025 të ndarë sipas njësive administrative.

| Njësia | Nr. i pagesave | Vlera |
|---|---|---|
| Nj. Adm. Remas | 646 | 1,463,610 |
| Nj. Adm. Tërbuf | 915 | 1,114,190 |
| Nj. Adm Grabian | 319 | 644,205 |
| Nj. Adm. Gradishtë | 845 | 2,090,993 |
| Nj. Adm Divjakë | 1,021 | 1,564,514 |
| Total | 3,746 | 1,463,610 |

## ❖ II- VËSHTRIM MBI SHPENZIMET E REALIZUARA PËR PERIUDHËN JANAR -DHJETOR 2025

### Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për periudhën Janar-Gusht 2025

Bashkia Divjakë në mbështetje të ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ka miratuar Buxhetin e vitit 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, Faza Perfundimtare të cilat janë miratuar me vendim te Këshillit Bashkiak nr.65 dt.24.12., të miratuara nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr.1359/1 prot dt.31.12.2024protokolluar në Bashkinë Divjakë nr.18 prot dt.06.01.2025

Me vendimin e KB nr.05 dt.24.01.2025është miratuar një rishpërndarje fondesh në të cilin pakësohen fondet e Agjensisë së Shërbimeve Komunale dhe Shtohen në Buxhetin e Bashkisë Divjakë,
Me Vkb nr.12 dt.24.02.2025 është miratuar shpërndarja e të ardhurave të trasheguara nga viti 2024, miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresen nr.268/1 dt.03.03.2025. Pas rakordimit me thesarin ky buxhet u bë efektiv për Bashkinë Divjakë, si dhe me ndryshimet për rialokime, rishpërndarje të bëra gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025.

## REALIZIMI I BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

**Realizimi i Buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2025 sipas Njësive Shpenzuese (në 000/lekë)**

| | Plani | Fakti | Real% |
|---|---|---|---|
| BASHKIA DIVJAKE | 1,019,966 | 691,676 | 68 |
| AGJENSIA E SHERBIMEVE KOMUNALE | 109,512 | 101,756 | 93 |
| FINANCIMI I HUAJ | 1,841 | 41 | 2 |
| **Buxheti Total Grupi 00** | **1,131,319** | **793,473** | 70 |
| **Granti i Kushtezuar** | 482,163 | 377,750 | 78 |
| **Buxheti Grupi 00+Granti i Kushtezuar** | **1,613,482** | **1,171,223** | 73 |

Buxhet është i ndarë si më poshtë:
-Institucionii Bashkisë Divjakë.
-Agjensia e Shërbimeve Komunale (njësi shpenzuese).

Buxheti i Institucionit të Bashkisë Divjakë për grupin 00 për periudhën Janar-Dhjetor 2025 sipas plan buxhetit është 1,019,966 mijë lekë dhe realizuar 691,676 mijë lekë ose 68%.
Buxheti i Agjensisë së Shërbimeve Komunale për grupin 00 për periudhën Janar-Dhjetor 2025 sipas plan buxhetit është 109,512 mijë lekë dhe është realizuar 101,756 mijë lekë ose 93%.
Buxheti nga Projekti me Bashkëfinancim me fondet e Be, Projekti Ipa Adrion JOINABLE për periudhën Janar Dhjetor 2025 sipas plan Buxhtit është 1,841 mijë lekë dhe realizuar 41 mijë lekë osë 2%, pjesa tjetër e pa shpenzuar ka kaluar si e ardhur e trasheguar nga financimet e huaja(02), në Buxhetin e vitit 2026.
**Në total Buxheti I Bashkisë Divjakë për grupin 00 për periudhën Janar –Dhjetor 2025 sipas plan Buxhetit është 1,131,319 mijë lekë dhe realizuar 793,473 mijë lekë ose 70%.**

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 nga krahasimi i planit të rishikuar të buxhetit të vitit 2025 me planin fillestar të buxhetit të vitit 2025, rezulton një diferencë prej 632,246 mijë lekë.
-Nga të cilat: nga të ardhura të trasheguara nga viti 2024- 125,530 mijë lekë miratuar me VKB nr.12 dt.24.02.2025,konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr.268/1dt.03.03.2025,janë

trashëguar nga Transferta Sektoriale 58,463 mijë lekë, nga Transferta e Pakushtëzuar 12,719 mijë lekë, nga të Ardhurat Vendore 53,463 dhe nga të ardhura jashtë limitit 885 mijë lekë.
-Me vkb nr.42 datë.23.07.2025 është bërë shtimi I të ardhurave dhe shpenzimeve në Buxhetin e Vitit 2025 nga financimet e huaja në kuadër të projektit JOINABLE nëpërmjet programit Interreg IPA ADRION, në vlerën 1,840,878 lekë.
-Gjithashtu kemi pasur rialokime fondesh nga fondi si edhe vendime të këshillit bashkiak për lëvizje fondesh mes programeve.
-Gjithashtu kemi pasur shtesa nga ministritë e linjës (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,Ministria e Brëndëshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Bujqwsisw etj)
-Shtesë fondi nga Emergjenvcat Civile.

❖ **V-VËSHTRIM MBI SHPENZIMET SHPENZIMET KAPITALE**

## ANEKSI NR.5 "PROJEKTET E INVESTIMEVE ME FINANCIM TË BRENDSHËM DHE ME FINANCIM TË HUAJ" VITI 2025

**Projektet me financim të brendshëm (në 000/lekë)**

| Kodi projektit | Emërtimi i projektit | Vlera e plotë e projektit | Viti i fillimit të projektit | Viti i përfundimit të projektit | Buxheti / Kontraktuar | Plani i buxhetit viti 2025 | REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale | REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore) | REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale | Komente | Programi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1470157 | Blerje mjete transporti, mjete germimi dhe mjete nivelimi per nevojat e Bashkise Divjake, Loti I II-te (Fadrome e re)kontrata 5171/23 dt.25.10.2024 | 8,801 | 2024 | 2025 | 8,801 | 8,801 | 8,801 | 8,801 | 8,801 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01.04520 |
| 1470158 | Blerje mjete transporti, mjete germimi dhe mjete nivelimi per nevojat e Bashkise Divjake, Loti I II-te (Minieskavator e re)kontrata 5171/23 dt.25.10.2024 | 8,356 | 2024 | 2025 | 8,356 | 8,356 | 8,356 | 8,356 | 8,356 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01.04520 |
| 1470155 | Blerje mjete transporti, mjete germimi dhe mjete nivelimi per nevojat e Bashkise Divjake, Loti I II-te (1 Eskavator me goma me kova te ndryshme | 22,963 | 2024 | 2025 | 22,963 | 22,963 | 22,963 | 22,963 | 22,963 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01.04520 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | )kontrata 5171/23 dt.25.10.2024 | | | | | | | | | |
| 1470168 | Blerje droni dhe paisje per matje Gjeodezike kontrata.7434/15 dt.13.12.2024 | 3,450 | 2024 | 2025 | 3,450 | 3,450 | 3,450 | 3,450 | 3,450 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01.04130 |
| 1470107 | Blerje binderi per asfaltimin e rrugeve urbane te Bashkise Divjake per vitin 2023 kontrata772/16 dt.26.04.2023 | 55,997 | 2023 | 2025 | 55,997 | 8,707 | 8,707 | 8,707 | 55,997 | Investim I Vitit 2023,Realizuar | 00.01.04520 |
| 1470144 | Blerje materiale elektrie per ndricimin e rrugeve viti 2024 kontrata 518/13 dt.02.09.2024 | 9,500 | 2024 | 2025 | 9,500 | 9,500 | 9,500 | 9,500 | 9,500 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01.04520 |
| 1470154 | Blerje mjete transporti dhe mjete nivelimi per nevojat e Bashkise Divjake Loti I I-re (2 kamion 4 aksial)Kontrata 771/2 dt.04.02.2025 | 36,720 | 2024 | 2025 | 36,720 | 36,720 | 36,720 | 36,720 | 36,720 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01.04520 |
| 1470159 | Blerje mjete transporti dhe mjete nivelimi per nevojat e Bashkise Divjake Loti I I-re (1 kamion 2-3 aksial+4 ton)Kontrata 771/2 dt.04.02.2025 | 7,429 | 2024 | 2025 | 7,429 | 7,429 | 7,429 | 7,429 | 7,429 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01.04520 |
| 1470163 | Blerje mjete transporti dhe mjete nivelimi per nevojat e Bashkise Divjake Loti I I-re (Kamioncine 3.5 ton)Kontrata 771/2 dt.04.02.2025 | 1,820 | 2024 | 2025 | 1,820 | 1,820 | 1,820 | 1,820 | 1,820 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01-05.01110 |
| 1470162 | Blerje mjete transporti dhe mjete nivelimi per nevojat e Bashkise Divjake Loti I I-re (2 Kamioncine dopi gabine 3.5 ton)Kontrata 771/2 dt.04.02.2025 | 3,952 | 2024 | 2025 | 3,952 | 3,952 | 3,952 | 3,952 | 3,952 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01.01110 |
| 1470121 | Blerje binderi për shtrimin e rrugëve urbane, Bashkia Divjakë. Viti 2024, | 61,133 | 2024 | 2025 | 61,133 | 32,133 | 32,133 | 32,133 | 37,132 | Investim I Vitit 2024, realizuar plan buxheti I vitit 2024 dhe vitit 2025 | 00.01.04520 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | kontrata 2858/19 dt.18.07.2024 | | | | | | | | | | |
| 1470122 | Blerje Cakell makinerie (1-100 mm) per rruget urbane Bashkia Divjake kontrata nr.4535/3 dt.18.06.2024 | 13,650 | 2024 | 2025 | 7,540 | 7,540 | 7,540 | 7,540 | 10,148 | Investim I Vitit 2024, | 00.01.0 4520 |
| 1470165 | Ambulanca Tip A-2 Kamenice Njad Divjake | 396 | 2024 | 2025 | 396 | 396 | 396 | 396 | 396 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01.0 110 |
| 1470170 | Ambulanca Tip A-2 Remas Njad Divjake | 396 | 2024 | 2025 | 396 | 396 | 396 | 396 | 396 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.05.0 110 |
| 1470160 | Rul 8 ton, per ngjeshjen e rrugeve te parcelave, kontrata 771/14 dt.07.03.2024 | 4,880 | 2024 | 2025 | 4,880 | 4,880 | 4,880 | 4,880 | 4,880 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01.0 110 |
| 1470161 | Greider per nivelimin e rrugeve te parcelave kontrata 771/14 dt.07.03.2024 | 5,920 | 2024 | 2025 | 5,920 | 5,920 | 5,920 | 5,920 | 5,920 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.05.0 110 |
| 1470156 | Eskavator Amfib per mirembajtjen e lagunes kontrata 5171/23 dt.25.10.2024 lotti II | 37,427 | 2024 | 2025 | 37,427 | 37,427 | 37,427 | 37,427 | 37,427 | Investim I Vitit 2024, realizuar | 00.01.0 4520 |
| 1470106 | Blerje cakell makinerie (sp1-100mm) per rruget urbane te Bashkise Kontrata 770/12 dt.21.03.2023 | 7,616 | 2023 | 2025 | 7,616 | 5,616 | 5,616 | 5,616 | 7,616 | Investim I Vitit 2023 realizuar | 00.01.4 520 |
| 1470178 | Blerje cakell makinerie (sp1-100mm) per rruget urbane dhe rurale ne Bashkine Kontrata 1595/21 dt.19.06.2025 | 25,986 | 2025 | 2027 | 25,986 | 4,112 | 3,368 | 3,368 | 3,368 | Ivestim I vitit 2025, ne proces | 00.01.0 4520 |
| 1470187 | Blerje mjetesh per nevojat e Bashkise Divjakedhe Agjensise se Sherbimeve Komunale(Autobot uji per ujerat e zeza) | 3,024 | 2025 | 2025 | 3,024 | 3,024 | 3,024 | 3,024 | 3,024 | Ivestim I vitit 2025, realizuar | 00.01/0 5.01110 |
| | Blerje mjetesh per nevojat e Bashkise Divjakedhe Agjensise se Sherbimeve Komunale(Makine per policine Bashkiake) | 1,920 | 2025 | 2025 | 1,920 | 1,920 | 1,920 | 1,920 | 1,920 | Ivestim I vitit 2025, realizuar | 00.05.0 3140 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Blerje mjetesh per nevojat e Bashkise Divjakedhe Agjensise se Sherbimeve Komunale(makine me kosh) | 4,860 | 2025 | 2025 | 4,860 | 4,860 | 4,860 | 4,860 | 4,860 | Ivestim I vitit 2025, realizuar | 00.01.04240 |
| | Permiresimi I Banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara | 1,024 | 2025 | 2026 | 1,024 | 1,024 | 418 | 418 | 418 | Ivestim I vitit 2025, ne proces | 00.05..010430 |
| 1470177 | Blerje binderi(Furnizim Vendosje) per shtrimin e rrugeve urbane ne Bashkine Divjake kontrata e vitit 2025 | 56,742 | 2025 | 2027 | 7,743 | 7,743 | 7,743 | 7,743 | 7,743 | Ivestim I vitit 2025, likujduar pjesa e plan buxhetit te vitit 2025 | 00.01.04520 |
| | Ndertim palestre e mbuluar dhe rikonstruksion I Shkolles se Mesme te Bashkuar, Cerme Sektor Njad terbuf. | 59,605 | 2022 | 2023 | 59,605 | 3,372 | 3,372 | 3,372 | 59,605 | investim I vitit 2022(me bashkefinancim ml dhe Bashkia), paguar plotesisht. Vlera e shenuar e kontrates eshte e plote | 00.01.09230 |
| | **SHUMA 12-MUJORE, BUXHETI BASHKISË DIVJAKË** | | | | | | **230,711** | **230,711** | **343,841** | | |
| | **MINISTRI LINJE** | | | | | | | | | | |
| 18BD057 | Rikonstruksion i objekteve, shtesë anësore dhe ndërtim palestre në shkollën e mesme të bashkuar Remas, Ministri Linje Viti 2024. | 88,731 | 2024 | 2025 | 76,510 | 59,939 | 6,725 | 6,725 | 42,546 | Kontratë e vitit 2024 me shtrirje edhe në vitin 2025. Likujdimi për vitin 2024 është realizuar. Ne proces likujdimi per vitin 2025 | 11.01.09230 |
| 19AFB14 | Furnizimi me uje për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësisë Administrative Remas | 496,126 | 2021 | 2024 | 496,126 | 53,205 | 53,205 | 53,205 | 496,125 | Kontratë e vitit 2021, paguar në vitin 2021-2025 (442,920 mijë lekë).Realizuar si kontrate | 06.01.06370 |
| 22AC520 | Ndertim I shkolles 9-vjecare Ismail Veizi Babunje, Bashkia Divjake | 56,715 | 2024 | 2024 | 63,182 | 63,182 | 17,650 | 17,650 | 17,650 | Kontrate e vitit 2024, ne proces | 11.01.09120 |
| 18AJ969/ 18AJ970 | Nderhyrje emergjente nga erozioni dhe sistemimi I ujerave ne fshatin Grabian, Kryekuq, Zherrnec grupi 05 | 6,404 | 2024 | 2025 | 6,404 | 6,404 | 6,404 | 6,404 | 6,404 | Kontrate e vitit 2024, realizuar | 05.01.04240 |
| 18AZ901 | Nderhyrje emergjente nga erozioni dhe sistemimi I | 43,729 | 2024 | 2025 | 43,729 | 43,729 | 43,405 | 43,405 | 43,405 | Kontrate e vitit 2024, nrealizuar | 17.01.10910 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ujerave ne fshatin Grabian, Kryekuq, Zherrnec grupi 17 | | | | | | | | | | |
| | Permiresimi I Banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara | 2,559 | 2025 | 2025 | 2,559 | 2,559 | 2,559 | 2,559 | 2,559 | Kontrate e vitit 2025, nrealizuar | 04.01.0 6190 |
| | **SHUMA 12-MUJORE, MINISTRI LINJE** | | | | | | **129,948** | **129,948** | **608,689** | | |
| | **SHUMA 12-MUJORE TOTAL** | | | | | | **360,659** | **360,659** | **952,530** | | |
| | **NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE KOMUNALE** | | | | | | | | | | |
| | Blerje saldatrice, trako dhe trapan | 300 | 2025 | 2025 | 300 | 300 | 144 | 144 | 144 | Investim I Vitit 2025, realizuar | |
| | Blerje ferline dhe motorrseke | 200 | 2025 | 2025 | 200 | 200 | 188 | 188 | 188 | Investim I Vitit 2025, realizuar | |
| | Blerje korrese ligustrash dhe fryrese per gjethet | 120 | 2025 | 2025 | 120 | 120 | 88 | 88 | 88 | Investim I Vitit 2025, realizuar | |
| | **SHUMA ASHK** | | | | | | **420** | **420** | **420** | | |
| | **SHUMA BASHKIA+ASHK** | | | | | | **361,079** | **361,079** | **952,950** | | |

## ❖ ANALIZË E LIKUJDIMIT TË INVESTIMEVE

### o INVESTIMET E BASHKISË DIVJAKË

-Blerje mjete transporti, mjete germimi dhe mjete nivelimi për nevojat e Bashkisë Divjakë, Loti i II-të(Fadromë e re).(Investim I Vitit 2024) Kontrata është e lidhur në vlerën 8,801 mijë lekë dhe likujduar në vlerën 8,801 mijë lekë. Realizuar Si Kontratë

-Blerje mjete transporti, mjete gërmimi dhe mjete nivelimipër nevojat e Bashkisë Divjakë loti i II-të (Minieskavator I ri), (Investim I vitit 2024), Kontrata është lidhur në vlerën 8,356 mijë lekë dhe likujduar nmë vlerën 8,356 mijë lekë. ( Realizuar Si Kontratë).

-Blerje mjete transporti, mjete germimi dhe mjete nivelimi për nevojat e Bashkisë Divjakë, Loti i II-të(1 Eskavator me goma me kova të ndryshme)).(Investim I Vitit 2024), Kontrata është lidhur në vlerën 22,963 mijë lekë dhe është likujduar në vlerën 22,963 mijë lekë. (Realizuar si Kontratë).

-Blerje droni dhe paisje për matje gjeodezike (Investim I vitit 2024). Kontrata është lidhur në vlerën 3,450 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 3,450 mijë lekë.

-Blerje binderi për asfaltimin e rrugëve urbane të Bashkisë Divjakë për vitin 2023. (Investim I vitit 2023), Kontrata është lidhur në vlerën 55,997 mijë lekë dheështërealizuar në vlerën 55,997 mijë lekë. (Realizuar Kontrata)

-Blerje materiale elektrike për ndricimin e rrugëve viti 2024. (Investimi I vitit 2024) Kontrata është lidhur në vlerën 9,500 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 9,500 mijëlekë(Realizuar kontratat)

-Blerje mjete transporti, mjete germimi dhe mjete nivelimi për nevojat e Bashkisë Divjakë, Loti i II-të(2 kamion 4 aksial ).(Investim I Vitit 2024) Kontrata është e lidhur në vlerën 36,720 mijë lekë dhe është likujduar në vlerën 36,720 mijë lekë. (Realizuar Si Kontratë).

-Blerje mjete transporti, mjete germimi dhe mjete nivelimi për nevojat e Bashkisë Divjakë, Loti i II-të(1 kamion 2-3 aksial+4 ton).(Investim I Vitit 2024) Kontrata është e lidhur në vlerën 7,429 mijë lekë dhe është likujduar në vlerën 7,429 mijë lekë. (Realizuar Si Kontratë).

-Blerje mjete transporti, mjete germimi dhe mjete nivelimi për nevojat e Bashkisë Divjakë, Loti i II-të(Kamioncine 3.5 ton).(Investim I Vitit 2024) Kontrata është e lidhur në vlerën 1,820 mijë lekë dhe është likujduar në vlerën 1,820 mijë lekë. (Realizuar Si Kontratë).
-Blerje mjete transporti, mjete germimi dhe mjete nivelimi për nevojat e Bashkisë Divjakë, Loti i II-të(2 kamioncine doppio gabine 3.5 ton).(Investim I Vitit 2024) Kontrata është e lidhur në vlerën 3.952 mijë lekë dhe është likujduar në vlerën 3,952 mijë lekë. (Realizuar Si Kontratë).
-Blerje binderi për asfaltimin e rrugëve urbane të Bashkisë Divjakë për vitin 2024. (Investim I vitit 2024), Kontrata është lidhur në vlerën 61,133 mijë lekë(e ndare ne 3vite per likujdim viti 2024, viti 2025, viti 2026) dhe është likujduar në vlerën 37,132 mijë lekë duke u likujduar kështu plan buxheti I vitit 2025 per kete projekt. Investim në process likujdimi për plan buxhetin e vitit 2026.
-Blerje Çakëll makinerie(1-100mm) për rrugët urbane Bashkia Divjakë. (Investim I vitit 2024). Kontrata është lidhur në vlerën 61,133 dhe likujduar në vlerën 10,148 mijë lekë.
-Ambulanca Tip A-2 Kamenicë Njad Divjakë Kontratë e vitit 2024 në marrveshje me Gjysëm Hënën e Kuqe , pjesa takuese e Bashkisëështë në vlerën 396 mijë lekë dhe likujduar në vlerën 396 mijë lekë. (Realizuar Kontrata/Marrveshja).
-Ambulanca Tip A-2 Remas Njad Divjakë Kontratë e vitit 2024 në marrveshje me Gjysëm Hënën e Kuqe , pjesa takuese e Bashkisëështë në vlerën 396 mijë lekë dhe likujduar në vlerën 396 mijë lekë. (Realizuar Kontrata/Marrveshja).
-Rul 8 ton, për ngjeshjen e rrugëve të parcelave, kontrata është lidhur në vlerën 4,880 lekë dhe likujduar në vlerën 4,880 lekë (Realizuar si kontratë).
-Grejder për nivelimin e rrugëve të parcelave, Kontrata është lidhur në vlerën 5,920 lekë dhe likujduar në vlerën 5,920 lekë (Realizuar si kontratë).
-Eskavator Amfib për mirëmbajtjen e lagunës, Kontrata është lidhur në vlerën 37,427 lekë dhe likujduar në vlerën 37,427 lekë (Realizuar si kontratë).
-Blerje cakell makinerie(sp1-100mm) per rruget urbane te Bashkise Divjake, Kontrata është e vitit 2023 e lidhur në vlerën 7,616 mijë lekë dhe likujduar në vlerën 7,616 mijë lekë (Realizuar si kontratë).
- Blerje cakell makinerie(sp1-100mm) per rruget urbane te Bashkise Divjake, Kontrata është e vitit 2025 e lidhur në vlerën 25,986 mijë lekë, me shtrirje per 3 vite, viti 2025 është planifikuar në vlerën 4,112 mijë lekë dhe likujduar në vlerën 3,368 mijë lekë (kontratë në proces).
-Blerje mjetesh per nevojat e Bashkise Divjake dhe Agjensise se Sherbimeve Komunale(Autobot Uji per ujerat e zeza)Kontrata lidhur ne vleren 3,024 mijë lekë dhe likujduar në vlerën 3,024 mijë lekë(Realizuar).
-Blerje mjetesh per nevojat e Bashkise Divjake dhe Agjensise se Sherbimeve Komunale(Makine për policinë Bashkiake)Kontrata lidhur ne vleren 1,920 mijë lekë dhe likujduar në vlerën 1,920 mijë lekë(Realizuar).
-Blerje mjetesh per nevojat e Bashkise Divjake dhe Agjensise se Sherbimeve Komunale(Makine me kosh)Kontrata lidhur ne vleren 4,860 mijë lekë dhe likujduar në vlerën 4,860 mijë lekë(Realizuar).
-Përmirësimi I banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara Kontratë e lidhur në Bashkëfinancim me Ministrinë e Bujqësisë 80% ministria e Bujqësisë dhe 20% Bashkia Divjakë. Pjesa e Bashkisë Divjakë e kontratës është 1,024 mijë lekë dhe realizuar 418 mijë lekë(Investim në process)
-Blerje Binderi(Furnizim, Vendosje) për shtrimin e rrugëve urbane Bashkia Divjake, Kontratë e vitit 2025 e lidhur në vlerën 56,742 mijë lekë me likujdim ne vitet 2025,2026,2027, likujduar vlera

prej 7,743 mijë lekë që është edhe plan Buxheti për vitin 2025. Ne vitin 2026 vijon likujdimi për plan Buxhetin e vitit 2026 për këtë investim.
-Ndërtim palestre e mbuluar dhe rikonstruksion I Shkolles së Mesme të Bashkuar , Cerme Sektor Njad Terbuf. Kontrate e vitit 2022 e lidhur në vlerë 59,605 likujduar në total 59,605(Realizuar).

- **INVESTIMET E AGJENSISE SE SHERBIMEVE KOMUNALE**

-Blerje saldatrice, Trako dhe trapan, prokurim I vitit 2025 likujduar plotesisht ne vleren 144 mije leke.
-Blerje ferrline dhe motorrseke, prokurim I vitit 2025 likujduar plotesisht ne vleren 188 mije leke.
-Blerje motorrseke ligustrash dhe fryrese gjethesh, prokurim I vitit 2025, likujduar plotesisht ne vleren 88 mije leke.

- **INVESTIMET MINISTRI LINJE**

-Rikonstruksion I objekteve, Shtesë Anësore dhe ndërtim palestre në Shkollën e Mesme të Bashkuar Remas. (Kontrataë e vitit 2024 e cila është me shtrirje likujdimi edhe në vitin 2025, likujdimi I vitit 2024 është realizuar dhe është në process realizimi I vitit 2025. Kontrata është lidhur në vlerën 88,731 mijë lekë dhe është likujduar në vlerën 42,546 mijë lekë.
-Furnizimi me uje per zonat bregdetare të Bashkise Divjake dhe Njesise Administrative Remas(Kontrate e vitit 2021), e lidhur në vlerën 496,126 mije lekë, paguar per vitet 2021-2024 vlera prej 442,920 mije leke dhe paguar ne vitin 2025 vlera prej 53,205 mijë lekë(Realizuar si kontrate).
-Ndërtimi I Shkollës 9-Vjecare Ismail Veizi Babunjë, Bashkia Divjakë lidhur kontratat per pjesën e Ministrisë në vlerën 56,715 mijë lekë dhe likujduar 17,650 mijë lekë(Në procës likujdimi).
-Ndërhyrje emergjente nga erozioni dhe sistemimi I ujerave ne Fshatin Grabian, Kryekuq, Zherrnec.Kontrate e lidhur me fondet e akorduara nga Ministria e Brendeshme(AKMC) dhe Ministria e Bujqesise, Kontrata e lidhur në vlere 43,729 mijë lekë per pjesen e AKMC-së dhe likujduar në vlerë 43,405 mijë lekë, si edhe kontrata për pjesën e Ministrisë së Bujqësisë është lidhur në vlerë 6,404 mijë lekë dhe likujduar në vlerën 6,404 mijë lekë.

***Bashkia Divjakë ka mbajtur në monitorim shpenzimet financiare të Bashkisë ku niveli i detyrimeve të prapambetura për periudhën Janar -Dhjetor 2025 është 42,236 mijë lekë.***

***Situata financiare e Bashkisë sipas vetëvlerësimit financiar për Periudhën Janar-Dhjetor 2025 është normale, koefiçienti vetëvlerësimit është 5.32%.***

**Pasqyrat e vetëvlersimit Financiar për Periudhën Janar-Dhjetor 2025 (në lekë)**

**Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiar normale dhe rastet e vështirësive financiare**

**Muaji Dhjetor 2025**

| N.R | Emërtimi | Stoku në vlerë | Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në | Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së |
|---|---|---|---|---|
| I | **Borxhe (a+b)** | 0 | | |
| a | **Hua afatgjatë** | 0 | | |
| a,1 | Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overcraftt etj) | | | |
| a,2 | Tituj të emetuar | | | |
| a,3 | Garanci për të tretë | | | |
| b | **Hua afatshkurtër** | 0 | | |
| b,1 | Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overcraftt etj) | | | |
| b,2 | Tituj të emetuar | | | |
| b,3 | Garanci për të tretë | | | |
| | | | | |
| II | **Detyrimet e prapambetura** | **42,235,524** | | **5.32%** |
| **Llogaria ekonomike** | **Emërtimi** | | | |
| 4864100 | Vendime Gjyqesore | 29,797,647 | | |
| 4864200 | Det.Prap. Sherbime | 1,742,982 | | |
| 4864201 | D.P.EneriElektirke | | | |
| 4864300 | Det.Prap.Mirembajtje | | | |
| 4864400 | Det.Prap. Investime | 2,582,718 | | |
| 4864500 | Det.Prap.Rimbursi.TVSH | | | |
| 4864600 | Mallra | 8,112,177 | | |
| 4864900 | Det.Prap.Te Tjera | | | |
| 4864601 | Det.Prap.Sig.Shoqerore | | | |
| 4864602 | Det.Prap.Sig.Shendet | | | |
| 4864603 | Det.Prap.Ardh.Personal | | | |
| 4864604 | Det.Prap.Tatime Tjera | | | |
| 4864901 | Paga | | | |
| 4864902 | Shpronesime | | | |
| 4864903 | Trans.indiv | | | |
| 4864904 | Trans.Subjektet | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| III | **Totali (I+II)** | **42,235,524** | **793,473,206** | **5.32%** |

| Detyrime pushteti qendror | Llogaria ekonomike | Vlera ne leke |
|---|---|---|
| Ministri linje grup 06 | 4864400 | 37.68 |
| FSHZH | | |
| Fonde nga Rindertimi | | |
| Totali | | 37.68 |

*Në lekë*

| Situata Normale e gjendjes fianciare | Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Probleme financiare | Vështirësi financiare | Vështirësi serioze financiare | Paaftësi paguese |
| | Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15% | Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25% | Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80% | Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130% |
| Situat Normale e gjendjes financiare | 0 | 0 | 0 | 0 |

**BASHKIA DIVJAKE**

**Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore**

*në lekë*

| Nr. | E M E R T I M I | Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv) 31 DHJETOR 2025 | Vlera e Buxhetit vjetor (Plan) 2025 |
|---|---|---|---|
| I | **Të ardhurat e Pushtetit Vendor** | **208,185,331** | **218,620,000** |
| 1 | Taksat e veta vendore | 68,052,000 | 84,867,000 |
| a. | Taksa mbi pasurinë | 58,510,000 | 75,258,000 |
| b. | Biznesi i vogel | 0 | 0 |
| c. | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 9,047,000 | 9,000,000 |
| d. | Taksa të tjera vendore | 495,000 | 609,000 |
| 2 | Të ardhura jotatimore | 97,767,140 | 97,331,000 |
| a. | Tarifat e sherbimeve publike | 39,930,000 | 41,435,000 |
| b. | Tarifa administrative | 21,824,000 | 22,135,000 |
| c. | Të tjera jo tatimore | 36,013,140 | 33,761,000 |
| 3 | Taksa të ndara | 42,366,191 | 36,422,000 |
| a. | Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme | 78,000 | 440,000 |
| b. | Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura | 20,494,000 | 18,000,000 |
| c. | Renta minerare | 0 | 0 |
| d. | Tatim mbi të ardhurat personale | 18,467,191 | 11,930,000 |
| e. | Të tjera | 3,327,000 | 6,052,000 |
| II | **Shpenzime te Buxhetit Vendor** | **793,473,206** | **1,131,319,342** |
| 1 | Shpenzime Korrente | 562,342,366.00 | 702,886,833.83 |
| a. | Paga dhe fond i veçantë për paga | 358,412,825.00 | 389,219,196.00 |
| b. | Kontributi për Sigurime Shoqërore | 58,374,800.00 | 64,620,361.00 |
| d. | Shpenizme Operative | 143,936,070.00 | 230,332,753.83 |
| e. | Të tjera korrente | 1,618,671.00 | 18,714,523.00 |
| 2 | Shpenzime Kapitale | 231,130,840.00 | 428,432,508.56 |
| 3 | Burimet e Financimit | **793,473,206.00** | **1,132,203,968.53** |
| a. | Të ardhurat e veta vendore | 162,975,164.00 | 278,002,465.34 |
| b. | Transferta e pakushtezuar | 354,437,849.00 | 491,456,224.05 |
| c. | Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale | 276,018,923.00 | 360,019,775.00 |
| d. | Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit) | | 884,626.14 |
| f. | Financimi i huaj | 41,270.00 | 1,840,878.00 |
| g. | Huamarrja Vendore Vjetore | | |

| Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për tre vitet në vazhdim | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë tre | | | | |
| Nr. | Bashkia/Këshilli i Qarkut | Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 | Diferencë (Fakt-Plan) | Shënime |
| | Bashkia Divjake | 42,235,524 | 21,117,763 | 21,117,762 | | 0 | |

## ❖ VI- VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI AKTIVITETIN E DREJTORIVE DHE SEKTORËVE KRYESOR TË BASHKISË DIVJAKË

✓ **OBJEKTI: SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI**

**Drejtuar :** Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit ,Bashkia Divjakë.

- Sektori i MZSH-së gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2025,në të gjithë veprimtarinë e tijë është organizuar nga zbatueshmeria e Legjislacionit Shqiptarë,për funksionimin,organizimin dhe drejtimin e Shërbimit te MZSH-së,kryesisht ligjit nr, 152/2015,ligjit mbi pushtetin vendor,porosive ,udhëzimeve detyrave të dhena nga Kryetari i Bashkisë per vitin 2025.Keto dhe të tjera janë parashtruar në programet e punës vjetore,të planizuara nga sektori I MZSH-së,me gjithë prioritetet dhe objektivat e parashikuara në perputhje me detyrat që ka sektori i MZSH-së dhe stacioni i saj zjarrfikës.
- **Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, Sherbimi i MZSH-së ka krijuar disa të ardhura :**
  1. Miratimi i projekteve të lejeve të ncertimit 26 me vlerë 250.000 lekë
  2. Çertifikata të Sigurisë nga zjarri : 5 me shumën 25.000 lekë
  3. Vërtetim për renie zjarri :5 vëretime me vlerën 5.000 lekë
  4. Të ardhurat e Sektorit të MZSH-së Divjakë për periudhen Janar-Dhjetor pë vitin 2025 në total= 280.000 lekë.
- **Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025,Sektori i MZSH-së Divjakë ka kryer në total 21 Akt-Ekspertime**, për zjarret e rëna në territorin e Bashkisë Divjakë,me kërkesë të Prokurorisë praë Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Pergjithshem Fier ,ku sipas VKM nr.607 dt 29.07.2020 "Për tarifat dhe llojet e sherbimeve që ofrohen nga Sherbimi i MZSH-së",kur akti i ekspertimit kërkohet nga Prokuroria nuk ka asnjë lloj tarife,përveç se kryerja e akt-ekspertimit në rastet e zjarreve të rëna në objekt,kur kërkohet nga subjektet fizike dhe juridike, tarifa eshtë 25,000 lekë.
- **Shpenzimet e kryera gjatë periudhë Janar-Dhjetor 2025 nga Sektori i MZSH-së Divjkë,te përdorura nga artikulli 602:**

1. Gjatë periudhn Janar-Dhjetor 2025,Sektori i MZSH-së Divjakë ka kryer disa blerje të ndryshme paisje dhe materiale zjarrfikëse të përdorura nga artikulli **602 .**

2. Gjatë vitit Janar-Dhjetor 2025,për sigurimin e jëtes së punonjësve të Sektorit te MZSH-së është shpenzuar shuma 187.500 lekë.
3. Dt.05.05.2025,deri më dt.31.12 2025 konsumi i karburantit kap vleren 1.357.200 lekë.
4. Dokumentacion i automjeteve te MZSH-së,siguracion,taksa,kolaudim =220.000 lekë.
5. Internet ,drita,uji,për vitin 2025 shuma e harxhur =300.000 lekë.
6. Kancelari per vitin 2025,me vlerën 100.000 lekë.
7. Uniforma kundra zjarrit dhe uniforma shëerbimi me vlerën 1.274.760 lekë.
8. Shkuma aerodinamike me vlerën 94.800 lekë.
9. Maska për terren në zjarre me vlerën 120.000 lekë.
10. Revizionim fiksesh me pluhur,shkum,CO2, me vlerën 94.800 lekë.
11. Rdio marrëse-dhënëse mr vlerën 79.000 lekë.
12. Materjle shërbimi zjarrëfikëse me vlerën 152.400 lekë.

- Në total të shpenzuara për vitn 2025,nga Sektori i MZSH-së Divjakë në artikullin 602 janë: 3.980.460 lekë.
- Pagat dhe sigurimet për periudhen Janar –Dhjetor 2025 sipas artikullit 600 dhe 601 kapin vleren 14.670.000 lekë
- **Në total të shpenzuara nga artikujt 600-601-602,me vlerën 18.650.460 lekë.**
